

Si të krijoni një konsorcium të suksesshëm për të aplikuar në projektet e financuara nga Bashkimi Evropian

Ky dokument është një udhëzues i shkurtër që është përgatitur nga Drejtoria e Integrimit Evropian dhe Projekteve në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) për të mbështetur Njësitë e Integrimit Evropian të bashkive të Shqipërisë në procesin e krijimit të konsorciumeve për pjesëmarrje në aplikime të programeve të financimit të Bashkimit Evropian. Udhëzuesi ofron orientime praktike mbi identifikimin e partnerëve të përshtatshëm, ndërtimin e partneriteteve strategjike dhe organizimin e një konsorciumi funksional dhe të aftë për të hartuar dhe zbatuar projekte cilësore, në përputhje me kërkesat dhe standardet e programeve të Bashkimit Evropian.

Rritja e kapaciteteve të bashkive për të ndërtuar partneritete ndërkombëtare përbën një element thelbësor në përgatitjen e tyre për menaxhimin dhe përthithjen e fondeve të Bashkimit Evropian, në kuadër të procesit të integrimit evropian të Shqipërisë dhe përgatitjeve për zbatimin e Politikës së Kohezionit. Prandaj, Njësitë e Integrimit Evropian kanë një rol kyç në identifikimin e mundësive të financimit, krijimin e rrjeteve të bashkëpunimit dhe koordinimin e proceseve të aplikimit në nivel vendor.

Në shumicën e programeve të financimit të Bashkimit Evropian, një ide e mirë apo një nevojë konkrete nuk është e mjaftueshme për të fituar financimin. Në shumë raste, cilësia e konsorciumit është një nga faktorët kryesorë që përcakton nëse projekti do të financohet ose jo. Në programet si Interreg IPA ADRION, Interreg Euro-MED, Interreg Europe, Horizon Europe, Erasmus+, Citizens, Equality, Rights and Values Programme (CERV) apo URBACT IV, konsorciumi përbën bazën mbi të cilën ndërtohet i gjithë projekti. Prandaj krijimi i një konsorciumi cilësor nuk duhet parë vetëm si plotësim i një kriteri për të plotësuar pranueshmërinë e kërkuar në thirrje, por si ndërtim i një partneriteti strategjik që garanton zbatimin me sukses të projektit që synoni të realizoni dhe arritjen e rezultateve të kërkuara nga Bashkimi Evropian.

Çfarë është një konsorcium?

Një konsorcium konsiderohet një bashkim subjektsh të ndryshme vendore, kombëtare, apo ndërkombëtare, të cilët vendosin të bashkëpunojnë si partnerë për të hartuar, aplikuar dhe zbatuar një projekt të financuar nga BE-ja. Çdo partner kontribuon me ekspertizën, burimet dhe përgjegjësitë e veta, të ndara sipas thirrjes ose në bazë të komunikimit të brendshëm mes partnerëve. Në përgjithësi, një konsorcium ka një partner kryesor ose drejtues (lead partner) dhe një ose më shumë partnerë nga fusha të ndryshme, në varësi të kriterëve të cilësuar në thirrjen për aplikime, të cilët mund të jenë të detyrueshëm, opcjonalë ose të këshillueshëm që të shtohen në një konsorcium. Partneri kryesor mbart detyrimin që të organizojë bashkëpunimin mes partnerëve dhe

të vendosë bashkërisht me partnerët mbi masën e përfshirjes së partnerëve në aktivitete apo në projekt.

Në varësi të programit, partnerët mund të jenë subjektet e mëposhtme:

- Institucione publike vendore, rajonale, kombëtare (si Bashki, Qarqe, Drejtori rajonale, Drejtori të Përgjithshme, Agjenci, Ministri, etj);
- Universitete ose institucione kërkimore;
- Organizata të shoqërisë civile (shoqata, qendra, institute, fondacione, etj);
- Dhoma tregtie, sindakata apo shoqata sipërmarrje;
- Kompani private apo institucione private;
- Organizata ndërkombëtare.
- Etj.

Shumica e programeve evropiane kërkojnë partnerë nga disa vende të ndryshme, pasi bashkëpunimi ndërkombëtar konsiderohet një element thelbësor i vlerës së shtuar evropiane.

Pse është i rëndësishëm konsorciumi?

Vlerësuesit e projekt-propozimeve nuk financojnë vetëm një ide. Ata financojnë një ekip pune të propozuar nga një konsorcium, që është në gjendje ta realizojë punë e projektit të propozuar.

Një konsorcium i mirë tregon se:

- projekti mbulon të gjithë ekspertizën e nevojshme;
- partnerët kanë përvojë të lartë në fushën përkatëse;
- rezultatet mund të testohen në vende të ndryshme;
- projekti ka ndikim evropian duke përfaqësuar vlerat evropiane;
- rezultatet do të vazhdojnë edhe pas përfundimit të financimit.

Në shumë raste, diferenca midis një projekti fitues dhe një projekti të refuzuar nuk është ideja, por cilësia e konsorciumit.

Si të përfshihemi në një konsorcium?

Hapat që duhet të ndiqen për të krijuar ose për t'u përfshirë në një konsorcium janë, si më poshtë:

Hapi 1: Identifikimi i nevojave

Gabimi më i zakonshëm është që të kërkohet një thirrje dhe më pas të formohet një ide projekti. Procesi i identifikimit të një thirrjeje duhet të jetë i kundërt. Njësia e Integritetit Evropian, që është përgjegjëse edhe për projektet evropiane në bashki, duhet të njohë mirë prioritetet, planet vendore dhe nevojat e bashkisë.

Fillimisht duhet të identifikohen nevojat konkrete me të cilat bashkia po përballet.

Për shembull:

- menaxhimi i mbetjeve;
- transporti urban;
- përmbytjet ose emergjencat civile;
- digjitalizimi i shërbimeve;
- përfshirja e të rinjve;
- ndihma për individët e kategorive vulnerabël;
- ekonomia vendore;
- turizmi i qëndrueshëm;
- efienca energjetike.

Më pas duhet të analizohet nëse ekziston një program i BE-së apo thirrje që financon zgjidhjen e kësaj nevoje.

Hapi 2: Gjetja e programit/thirrjes së duhur

Jo çdo ide përshtatet me çdo program. Programet financojnë iniciativa që bazohen mbi prioritetet e tyre të cilat janë të deklaruara në udhëzuesit e programeve dhe për të cilat do të shpallin thirrje për aplikime për financim të projekteve me buxhete të ndryshme dhe tematika që pasqyrojnë një ose më shumë prioritete.

Njësia e Integritetit Evropian duhet të analizojë:

- **Objektivat e thirrjes.** Në këtë pikë mund të vlerësoni nëse objektivat e thirrjes përkojnë me nevojat që bashkia ka dhe nëse ia vlen për të aplikuar;

- **Aktivitetet e pranueshme që mund të financohen;**
- **Aplikantët e pranueshëm.** Në këtë pikë, Njësia meson se cilat janë kriteret për partnerin kryesor dhe për partnerët e tjerë dhe cilat janë subjektet që mund të aplikojnë në thirrje;
- **Shtetet e pranueshme që mund të marrin pjesë në thirrje** (nëse subjektet nga Shqipëria mund të aplikojnë dhe çfarë partnerësh nga cilët shtete mund të kontaktoni për të formuar një konsorcium);
- **Buxhetin total dhe buxhetin e disponueshëm për projekt;**
- **Masën e bashkëfinancimit.** Në përgjithësi, programet e BE-së funksionojnë me bashkëfinancim. Në shumë pak raste mund të ndodh që një program të financojë 100% një projekt. Kjo është gjithmonë e përcaktuar qartë në udhëzuesin e thirrjes. Gjithashtu, masa e financimit nga programi i BE-së dhe masa se sa duhet të bashkëfinancojë një konsorcium përcaktohet në udhëzuesin e thirrjes. Konsorciumi vendos mes partnerëve të ndajë masën që i takon secilit partner për të kontribuar me bashkëfinancim. Një mënyrë mund të jetë duke përllogaritur masën e përfshirjes në aktivitete ose masën e përgjegjësive për organizimin e punës administrative dhe raportimeve. Nuk ka një rregull të saktë por përcaktohet mes palëve me komunikim dhe mirëkuptim në kuadër të partneritetit;
- **Mënyrën e aplikimit dhe dokumentacionin që duhet të përgatitet.** Në përgjithësi janë katër dokumenta kryesorë që plotësohen:
 - **Formulari i aplikimit,** ku përfshihet pjesa narrative e projektit;
 - **Formulari i aktiviteteve,** ku vendosen aktivitetet që propozohen për t'u kryer në kuadër të projektit;
 - **Formulari i buxhetit,** ku vendosen shumat e kërkuara për secilin aktivitet të propozuar;
 - **Formulari i kornizës llogjike,** ku përmbledhen në një kornizë përmbledhëse objektivat, rezultatet e pritshme dhe indikatorët e matjes së suksesit të një projekti.
- **Afatin e aplikimit.**

Programet ku bashkitë shqiptare janë të pranueshme dhe ku ato janë më të përshtatshme për të aplikuar janë, si më poshtë:

Në kuadër të Instrumentit IPA III 2021–2027, Shqipëria merr pjesë në programe të Bashkëpunimit Territorial Evropian, të cilat mundësojnë bashkëpunimin me institucione dhe organizata nga vendet e tjera pjesëmarrëse. Këto programe ofrojnë mundësi për bashkitë shqiptare që të përfshihen në projekte të përbashkëta në fusha me interes për zhvillimin vendor, në varësi të kriterëve dhe prioritetëve të përcaktuara në secilën thirrje për aplikim.

Programet IPA janë, si më poshtë:

A. Programe Bashkëpunimi Ndërkufitar (CBC)

Këto janë programe bilaterale midis vendeve candidate:

- IPA CBC Mali i Zi–Shqipëri
- IPA CBC Shqipëri–Kosovë
- IPA CBC Maqedoni e Veriut–Shqipëri

B. Programe CBC me Shtete Anëtare të BE-së

- Interreg IPA CBC e Adriatikut Jugor “Itali–Shqipëri–Mali i Zi” (South Adriatic)
- Interreg IPA CBC “Greqi–Shqipëri”

C. Programe Transkombëtare (Interreg)

- Interreg IPA Adriatic-Ionian (ADRION)
- Interreg Euro-MED
- Interreg Europe
- Interreg URBACT IV – rrjete qytetesh dhe shkëmbim praktikash.

Nisur nga funksionet që ushtrojnë, bashkitë shqiptare kanë mundësi të aplikojnë në disa programe të Bashkimit Evropian që menaxhohen drejtpërdrejt nga Komisioni Evropian. Programet më të përshtatshme janë si më poshtë:

1. Programi Qytetarët, Barazia, të Drejtat dhe Vlerat (Citizens, Equality, Rights, and Values (CERV)):

Programi CERV promovon vlerat themelore të BE-së, që janë demokracia, barazia dhe të drejtat themelore të shprehura në Traktatet e BE-së dhe në Kartën e të Drejtave Themelore. Shqipëria është e asociuar me CERV dhe merr pjesë në tre shtylla: Barazia, të Drejtat dhe Barazia Gjinore; Angazhimi dhe Pjesëmarrja e qytetarëve; Daphne mbi ndalimin e dhunës ndaj grave ose fëmijëve, por nuk merr pjesë në shtyllën Vlerat e Bashkimit (Union Values), e cila është e rezervuar për shtetet anëtare të BE-së.

2. Programi Erasmus+:

Erasmus+ është programi i BE-së për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin. Shqipëria merr pjesë në Programin Erasmus+ si Vend i tretë jo i lidhur me Programin në grupin Ballkani Perëndimor (Rajoni 1) ku bëjnë pjesë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Mali i Zi. Këto shtete mund të marrin pjesë vetëm në disa thirrje të caktuara të Programit, në varësi të kriterëve ose

kushteve specifike të secilës thirrje. Prandaj para se të konsideroni aplikimin në një thirrje të Programit Erasmus+ duhet të kontrolloni mirë nëse thirrja përfshin ose jo grupin Ballkani Perëndimor (Rajoni 1). Bashkitë shqiptare mund të marrin pjesë në programin Erasmus+ duke u përfshirë në projekte siç janë rinovimi i godinave shkollore, organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit ku përfshihen rinia, ose në projekte për të forcuar iniciativat rinore vendore dhe aktivitetet sportive, etj. Projektet e zakonshme mund të përfshijnë bashkëpunime me shkolla ose OSHC vendore për të promovuar iniciativa arsimore.

3. Programi Horizon Europe:

Ky program është programi kryesor i BE-së për kërkimin shkencor dhe inovacionin. Programi strukturohet në tre shtylla kryesore: 1. Ekselencën shkencore, 2. Sfidat Globale dhe Konkurrenca Industriale Evropiane, dhe 3. Evropa Inovative, me një fokus shtesë në Zgjerimin e Pjesëmarrjes jashtë kufinjëve të BE-së dhe Forcimin e Hapësirës Evropiane të Kërkimit Shkencor. Në kuadër të asociimit të Shqipërisë me programin që nga viti 2021, si vend kandidat në BE, bashkitë shqiptare mund të marrin pjesë në Horizon Europe në kushte të barabarta me subjektet e tjera nga vendet anëtare të BE-së dhe mund të jenë si subjekt partner, ashtu edhe subjekt kryesor (Lead) në aplikime për projekte në konsorciume me shtete të ndryshme. Teknikisht, bashkitë mund të aplikojnë në të gjitha shtyllat, por praktikisht ato janë veçanërisht të përshtatshme për shtyllën e dytë në grupet tematike si në Grupin 2: Kultura, Kreativiteti dhe Shoqëria Gjithëpërfshirëse, që mbështet projekte mbi trashëgiminë kulturore dhe qeverisjen gjithëpërfshirëse; në Grupin 3. Siguria Civile për Shoqërinë, në fusha si Menaxhimi dhe rezistenca ndaj riskut të fatkeqësive; Mbrojtja e infrastrukturës kritike; dhe Përfshirja e qytetarëve në përgatitjen për fatkeqësitë; në Grupin 5: Klima, Energjia dhe Lëvizshmëria, që fokusohet në zhvillimin e qëndrueshëm urban; dhe në Grupin 6: Ushqimi, Bio-ekonomia, Burimet Natyrore, Bujqësia dhe Mjedisi. Projektet e zakonshme mund të përfshijnë ruajtjen e trashëgimisë kulturore, si dokumentimi digjital i ngjarjeve historike, dhe përpjekje për mobilitet urban, si krijimi i rrjeteve të transportit me karbon të ulët. Bashkitë mund të bashkëpunojnë me universitetet ose OSHC-të për të përmbushur kërkesat e konsorciumit duke dorëzuar propozime për thirrje të ngjashme me misionet e BE-së, si iniciativa “100 Qytete të Karbonit Neutral deri në 2030”, e cila promovon mësimin ndërmjet bashkive dhe planifikimin e qëndrueshëm urban vendor.

4. Programi Creative Europe:

Programi Creative Europe është iniciativa e BE-së që mbështet industrinë kulturore, krijuese dhe audiovizuale. Programi synon të nxisë diversitetin kulturor, konkurrencën dhe rritjen afatgjatë në industri të ndryshme. Programi strukturohet në tre shtylla: Kultura, Media dhe Qasja Ndërsektoriale. Projektet e zakonshme përfshijnë bashkëpunime kulturore për të mbështetur organizimin e festivaleve të filmit, arteve, kulturës dhe iniciativat të ngjashme. Bashkitë shqiptare mund të marrin pjesë në Creative Europe si pjesë e asociimit të Shqipërisë, veçanërisht në shtyllën

Kulturë, që mbështet projekte mbi trashëgiminë kulturore dhe artet lokale. Bashkitë mund të marrin pjesë gjithashtu në shtyllën Ndërsektoriale, që mbështet iniciativa që kombinojnë kulturën me industrinë krijuese. Projektet e zakonshme përfshijnë organizimin e ngjarjeve kulturore në territorin e bashkive për të promovuar historinë audiovizive shqiptare, duke përfshirë muzikën dhe artin tradicional, të cilat mund të gërshetohen me pjesëmarrjen e publikut nga shtetet anëtare të BE-së përmes shkëmbimit kulturor.

Hapi 3: Kërkimi i partnerëve të duhur

Një konsorcium nuk ndërtohet duke mbledhur sa më shumë partnerë. Ai ndërtohet duke mbledhur të gjithë subjektet që përcakton thirrja dhe duke mbuluar të gjitha kompetencat që kërkon projekt-propozimi që ju ose partneri kryesor, nëse ju nuk jeni partneri kryesor, ka ideuar. Prandaj nëse vendosni të merrni pjesë në një thirrje, edhe nëse nuk e keni ideuar akoma një ide projekti, kontrolloni kriteret mbi aplikantët e pranueshëm dhe i kontaktoni ata. Më pas diskutoni mbi idenë e projektit dhe ndarjen e roleve.

Një nga sfidat më të mëdha për bashkitë shqiptare është gjetja e partnerëve të besueshëm.

Burimet kryesore për të gjetur partnerë janë:

- Platforma e Komisionit Evropian: **EU Funding & Tenders Portal**:
<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/home>
- Faqja zyrtare e **programit CERV** për vetë-propozim partnerësh:
<https://eu.jotform.com/tables/230111180557041>
- Partner Search në faqet e programeve **Interreg**;
- Rrjetet rajonale të bashkive, siç është **NALAS**;
- Takimet e ndryshme “Partner Search” dhe “Info Days” që organizohen nga SASPAC, AKKSHI, EU4Innovation, etj.

Zakonisht, shumica e partnerëve gjenden përmes kontakteve të krijuara gjatë pjesëmarrjes në konferenca apo bashkëpunimve në projekte të mëparshme, ose binjakëzimeve të ndryshme që bashkitë bëjnë me bashkitë e shteteve të BE-së.

Hapi 4: Vlerësimi i partnerëve

Jo çdo subjekt që shpreh interes për të bashkëpunuar mund të jetë i aftë ose i duhur për t’u bërë pjesë e konsorciumit. Gjetja e partnerëve duhet të jetë në mënyrë selektive.

Duhet të vlerësohen:

- përvoja e mëparshme në projekte të BE-së;
- kapacitetet financiare për të përballuar shpenzimet në projekt;
- burimet njerëzore të disponueshme për t'i caktuar në projekt;
- ekspertiza teknike që disponon;
- aftësia për të përmbushur detyrat dhe aktivitetet brenda afateve;

Nëse një partner që nuk përmbush këto kritere mund të mos sjellë kontribut real dhe mund të dobësojë konsorciumin në fazën e vlerësimit të aplikimit ose, nëse projekti fitohet, në fazën e zbatimit të projektit.

Hapi 5: Ndarja e përgjegjësi

Përpara fillimit të hartimit të projektit duhet të përcaktohen qartë përgjegjësitë. Zakonisht konsorciumi i një projekti tipik të financuar nga Bashkimi Evropian organizohet sipas Paketave të Punës (Work Packages (WP)) dhe në to kryhet ndarja e roleve përkatëse për secilin partner të projektit.

Një ndarje e zakonshme e roleve mund të përfshijë:

- **WP1: Menaxhimi dhe koordinimi i projektit:** Kjo Paketë Pune zakonisht drejtohet nga partneri kryesor (Lead Partner), i cili cakton ekipin përgjegjës për koordinimin teknik, administrativ dhe financiar të projektit, monitorimin e progresit, komunikimin ndërmjet partnerëve dhe përgatitjen e raporteve periodike.
- **WP2: Komunikimi, vizibiliteti dhe promovimi i rezultateve:** Kjo Paketë Pune përfshin aktivitetet që lidhen me rritjen e vizibilitetit të projektit, komunikimin me grupet e interesit, shpërndarjen e rezultateve, organizimin e aktiviteteve informuese dhe garantimin e përdorimit sa më të gjerë të produkteve dhe rezultateve të krijuara nga projekti.
- **WP3: Zbatimi teknik dhe aktivitetet kryesore të projektit:** Kjo Paketë Pune mund të përfshijë partnerë të ndryshëm që kanë ekspertizën tematike dhe përgjegjësinë për zhvillimin e aktiviteteve, realizimin e produkteve (deliverables) dhe arritjen e objektivave specifike të projektit.
- **WP4: Pilotimi, testimi dhe vlerësimi i rezultateve:** Në varësi të natyrës së projektit, mund të përfshijë partnerë që ofrojnë zona për të kryer ndërhyrje apo aktivitete pilot, që të testohen dhe vlerësohen zgjidhjet e propozuara nga një projekt.
- **WP5: Qëndrueshmëria dhe shfrytëzimi i rezultateve:** Në këtë Paketë Pune përfshihen aktivitetet që synojnë garantimin e vazhdimësisë së rezultateve pas përfundimit të financimit,

integrimin e tyre në politikat vendore ose qendrore dhe promovimin e përdorimit të tyre nga aktorët përkatës të cilët janë synuar nga projekti për të sjellë një ndryshim.

Struktura dhe numri i Paketave të Punës ndryshon në varësi të programit dhe natyrës së projektit. Një konsorcium i mirë duhet të sigurojë që të gjitha funksionet kryesore të projektit të mbulohen nga partnerët me role dhe përgjegjësi të qarta.

Duhet të jetë e qartë:

- kush është partneri kryesor (lead partner);
- kush drejton secilën Paketë Pune;
- kush monitoron treguesit;
- kush harton raportet teknike;
- kush menaxhon raportimin financiar.

Zakonisht, nëse një ndarje e përgjegjësi nuk është e përcaktuar në Marrëveshjen e Grantit/Financimit (Grant Agreement), është praktikë e mirë të hartohet dhe nënshkruhet një Memorandum Mirëkuptimi ose një marrëveshje paraprake ndërmjet partnerëve për të përcaktuar ndarjen e roleve dhe përgjegjësi për mbarëvajtjen e punës së përbashkët.

Çfarë vlerësojnë zakonisht vlerësuesit e aplikimeve?

Zakonisht, vlerësuesit e aplikimeve në programet e Bashkimit Evropian vlerësojnë nëse konsorciumi:

- Plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në thirrjen për aplikim, duke përfshirë numrin minimal të partnerëve, përbërjen gjeografike të kërkuar, statusin ligjor të subjekteve pjesëmarrëse dhe çdo kërkesë tjetër specifike të programit.
- Ka ekspertizën dhe kapacitetet e nevojshme për zbatimin e projektit, duke vlerësuar përvojën e mëparshme të partnerëve, kompetencat teknike, burimet njerëzore dhe aftësinë institucionale për të realizuar aktivitetet e propozuara.
- Përfshin partnerë me role plotësuese dhe vlerë të shtuar të qartë, ku secili partner ka një kontribut të përcaktuar dhe një rol konkret në realizimin e Paketave të Punës dhe rezultateve të pritshme të projektit.
- Tregon që ka një bashkëpunim të mirëmenduar ndërkombëtar, ku partnerët kanë nevojë reale për njëri-tjetrin dhe se bashkëpunimi ndërkufitar ose ndërinstitutional sjell rezultate që nuk do të mund të arriheshin nga një subjekt i vetëm.

- Ka një shpërndarje të balancuar të përgjegjësiave dhe burimeve, ku detyrat, buxheti dhe përgjegjësitë ndahen në mënyrë proporcionale me kapacitetet dhe rolin e secilit partner.
- Ka aftësi për të arritur ndikim konkret dhe të matshëm, duke treguar qartë se si rezultatet e projektit do të përfitojnë grupet e synuara, komunitetet lokale, institucionet publike ose sektorët përkatës.
- Garanton qëndrueshmërinë e rezultateve pas përfundimit të financimit, përmes integritetit të produkteve të projektit në politikat, strategjitë ose praktikat institucionale të partnerëve.

Një konsorcium konkurrues nuk është domosdoshmërisht ai me numrin më të madh të partnerëve, por ai ku secili partner ka një rol të argumentuar mirë, ekspertizë relevante dhe ofron një kontribut të matshëm dhe të drejtpërdrejtë në arritjen e objektivave të projektit.

Zakonisht, mënyra e vlerësimit të një aplikimi është e publikuar në udhëzuesin e thirrjes së shpallur dhe përmban të gjithë indikatorët e vlerësimit që do të vlerësohen në bazë të përmbushjes ose jo të tyre ose në bazë të përqindjes së përmbushjes dhe përgjigjia përfundimtare mbi vlerësimin e aplikimit që do të dërgohet nga Komisioni Evropian, do të përmbajë vlerësimin në pikë ose në përqindje duke përmbledhur shumat e indikatorëve të plotësuar.

Roli i Njesisë së Integritetit Evropian në bashki

Njësitë e Integritetit Evropian kryejnë funksionin e gjetjes së partnerëve për të mundësuar përfshirjen e bashkisë së tyre në një konsorcium.

Praktikisht, puna e Njësive të Integritetit Evropian në lidhje me projektet përbën:

- identifikimin e nevojave prioritare të bashkisë;
- monitorimin e programeve të financimit të BE-së dhe thirrjeve të hapura;
- krijimin dhe përditësimin e databazës së partnerëve ndërkombëtarë;
- pjesëmarrjen në aktivitetet për kërkimin e partnerëve;
- koordinimin e komunikimit me partnerët;
- hartimin ose mbështetjen e partnerit kryesor me informacion mbi bashkinë në procesin e hartimit të koncept-idesë së projektit;
- mbledhjen e dokumentacionit administrativ në fazë aplikimi
- koordinimin e strukturave të tjera të bashkisë gjatë procesit të zbatimit të projektit, siç është bashkëpunimi me Sektorin e Financës mbi buxhetin dhe raportimet.

Gabimet më të zakonshme që duhen shmangur

Në përvojën e programeve të Bashkimit Evropian, gabimet që shfaqen më shpesh janë:

- fillimi i kërkimit të partnerëve vetëm pak javë përpara përfundimit të afatit të aplikimit;
- përfshirja e partnerëve vetëm për të plotësuar numrin minimal të kërkuar;
- mungesa e një roli të qartë për secilin partner;
- mosleximi i kërkesave specifike të thirrjes;
- zgjedhja e partnerëve pa përvojë ose pa kapacitet administrativ;
- mungesa e komunikimit të rregullt gjatë fazës së përgatitjes së projektit;
- ndërtimi i konsorciumit mbi marrëdhënie personale dhe jo mbi ekspertizë.

Një konsorcium i suksesshëm nuk krijohet disa javë përpara afatit të aplikimit. Ai ndërtohet gradualisht përmes rrjetëzimit, bashkëpunimit, besimit reciprok, përvojës së përbashkët dhe një vizioni të qartë për zgjidhjen e një problemi konkret që ju keni identifikuar për bashkinë tuaj. Prandaj Njësitë e Integritetit Evropian duhet të përqëndrohen në krijimin e partneriteteve ndërkombëtare të qëndrueshme dhe të vlefshme, pasi cilësia e konsorciumit mbetet një nga elementët më të rëndësishme për fitimin e projekteve dhe sigurimin e fondeve të Bashkimit Evropian.

Përgatiti: Visar Sylaj, Përgjegjës i Sektorit të Integritetit Evropian, Drejtorja e Integritetit Evropian dhe Projekteve, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.